



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:083399

Datë: 09.12.2022

Numri i dokumentit: 03732491

C.nr.1417/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtorin profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.A. nga Prizreni, me nr. personal të letërnjoftimit të cilën me autorizim e përfaqëson av. S.M.N. kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.M. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit 368.00 (treqind e gjashtëdhjetë e tetë) euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **09.12.2022**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses S.A. nga Prizreni, **si e bazuar**.
- II. DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditëses S.A. nga Prizreni, në emër të kompensimit të shujtave për 184 ditë pune (nga dt.14.09.2020 deri me dt. 02.07.2021), t’ia paguaj shumën prej nga 2 euro, apo **shumën e përgjithshme prej 368.00 (treqind e gjashtëdhjetë e tetë) euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 26.04.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET** e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **124 (njëqind e njëzetë e katër) euro**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësja S.A. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. S.M.N. pranë kësaj gjykate, me dt.26.04.2022, ka parashtruar padi, të cilën e ka precizuar me parashtruesin e dt.29.09.2022,kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin e shujtave, vlera e kontestit 368.00 euro.

E autorizuar e paditëses, në padi ka theksuar se paditësja S.A. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune SHFMU “Shtjefën Gjeçovi” në fsh. Komuna e Prizrenit, në bazë të kontratës së punës. Paditësja gjatë vitit 2021, pranë të paditurës ka qenë e pranishme në ditët e

punës prej 184 ditëve. Sipas të autorizuarës së paditëses, e paditura obligohet që punëtorëve të arsimit-këtu paditëses, t'ia kompensoi ushqimin gjatë orarit të punës dhe atë 2 euro për çdo ditë të paraqitur në punë, e kjo bazuar në nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të dt.22.01.2021. Andaj edhe gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta aprovojë në tërësi sitë bazuar. Me parashtrësën e dt.29.09.2022, i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësja nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtare të sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.07/L-001. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditëses është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata përmes vërtetimit me nr. të references 154/22, të dt.27.09.2022, lëshuar nga Drejtori i SHFMU “Shtjefën Gjeçovi” në fsh. Komuna e Prizrenit, vërtetoi faktin se paditësja S.A. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe gjatë vitit shkollor 2020/21, nga dt.14.09.2021 deri me 02.07.2021, e njëjta ka punuar 184 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi ky vërtetim është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimit të SHFMU “Shtjefën Gjeçovi” në fsh. Komuna e Prizrenit, gjykata i'a fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës dhe ditët e punës për paditësen S.A. nga Prizreni, përkatësisht paditësja gjatë vitit shkollor 2020/21, nga dt.14.09.2020 deri me 02.07.2021, e njëjta ka punuar 184 ditë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me nr. të njësisë 01B, nr.prot.2056, të dt.18.04.2017, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B,nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë

nëfuqi me datë 22.01.2021. Konkretisht për kompensimin e shujtave për ditët e punës gjatë vitit 2020 zbatohet kontrata e dt.18.04.2017 dhe për kompensimin e shujtave për ditët e punës gjatë vitit 2021 zbatohet kontrata e dt.22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), me nr. të njësisë 01B, nr. prot.2056, të dt.18.04.2017, është paraparë se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*. Po ashtu edhe me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, është përcaktua e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë *“Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*. Gjykata vlerëson se neni 35 par.7 i kontratave të lartcekura e mbulon kërkesëpadinë e paditëses për periudhën kohore të vitit 2020 dhe 2021.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si punëtore e arsimit t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lartcekura, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht lidhur me shpërblimin e ushqimisë gjatë ditëve të punës, për paditësen S.A. nga Prizreni, për 184 ditë pune. Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 7, pasi që për paditësen kërkesa është bërë e arritshme për 184 ditë pune, përkatësisht për periudhën prej 14.09.2020 deri me 02.07.2021, apo **shuma e përgjithshme prej 368.00 (treqind e gjashtëdhjetë e tetë) euro.**

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (26.04.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të

paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452.1, 453.2 dhe 463 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1417/2022, datë 09.12.2022

G j y q t a r i
Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën